



REPUBLIKA E SHQIPERISË

BASHKIA BELSH

Nr. ____ .prot

Belsh më, 21/07/2020

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL NË
KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Niveli minimal i diplomës “BAHCHELOR”,

në shkenca Shoqërore

Kategoria e pagës IV.b

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Korçë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

- **1 (një) Specialist i Emergjencave Civile, në sektorin e Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Territorit. Kategoria IV.b.**
- **1 (një) Specialist i Turizmit, në e Integritit dhe Mardhëniet me Diasporën , në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Integritit Evropian dhe Teknologjisë së Informacionit. Kategoria IV.b.**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele.

Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton vakant, atëherë është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë

Afati për dorëzimin e dokumentave për

30.07.2020

LEVIZJE PARALELE:

Afati për dorëzimin e dokumentave për

04.08.2020

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL:

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:

- Është nëpunës civil.
- Zbaton Strategjinë Kombëtare për zhvillimin e qendrueshëm të turizmit 2019-2023 dhe planin e veprimit në detyrat për të cilat AKT është institucioni përgjegjës, me qëllim ngritjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të imazhit turistik të vendit;
- Përgjegjës për hartimin, zhvillimin dhe zbatimin e planit vjetor të marketingut, të cilin ia paraqet për miratim në Bashki, në funksion të promovimit të turizmit shqiptar në nivel Vendor;
- Propozon panairët ndërkombëtare, kombëtare, “Fam Trip” dhe “Press Trip”, Eërkshop-e dhe Konferenca, si edhe forma të tjera për promovimin e produkteve dhe destinacioneve turistike shqiptare, me qëllim rritjen e fluksit turistik drejt Zonës tonë, duke e kthyer bashkinë Belsh në një destinacion të njohur në tregun e turizmit Kombëtar;
- Përgjegjës për realizimin e aktiviteteve të mësipërme promovionale, panairë ndërkombëtare, kombëtare “Fam-Trip” dhe “Press-Trip”, të cilat i realizon në përputhje me rregulloren e institucionit.
- Siguron planifikimin dhe hartimin e programit vjetor me qëllim përballimin e situatave të emergjencave;
- Përgatit raportet dhe informacionet për gjëndjen e sektorit të emergjencave;
- Merr masa dhe jep udhëzime për kryerjen e veprimtarive dhe funksionet që parashikohen nga ligjet të tjera.
- Ndjek zbatimin e urdhërave e të detyrave të dhëna nga Shefi i Sektorit dhe jep llogari para tij.
- Harton programet e punës (mujore dhe vjetore) dhe përgjigjet për realizimin e detyrave të përcaktuara në afat dhe në cilësinë e duhur.
- Përgatit informacione në mënyrë të rregullt dhe periodike për eprorin e drejtpërdrejtë dhe Drejtorin.
- Ndjek zbatimin e projekteve që janë në proces dhe raporton periodikisht tek eprori mbi statusin teknik dhe financiar, si dhe problemet e ndeshura gjatë zbatimit të tyre.
- Merr pjesë në grupe pune për vlerësimin e projekt propozimeve.
- Zbaton detyrat e dhëna nga Përgjegjësi dhe Drejtori.

1. LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon: a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori; b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi; c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mire”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

d- Të zotërojnë nivelin minimal të diplomës Bahchelor në Shkencat Agronomike.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Belsh, dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Belsh, brenda datës **30.07.2020**

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **02.08.2020**, njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë Belsh do të shpallë në faqen zyrtare të internetit të institucionit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

1.4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

1. Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
2. Ligjin nr. Nr.139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”;
3. Njohuritë mbi Ligjin nr. 93/2015, "Për turizmin", i ndryshuar;
Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
Njohuritë mbi VKM nr. 298, datë 20.4.2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit";
4. Njohuritë mbi "Strategjinë Kombëtare për zhvillimin e qendrueshëm të turizmit 2019-2023", (<http://ëëë.mjedisi.gov.al/ëp-content/uploads/2019/06/Strategjia-Kombëtare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>).
5. Ligj Nr. 45/2019 Për Mbrojtjen Civile
6. Nr. 664, Datë 18.12.2002 Për Kriteret Dhe Procedurat E Shpalljes Së Gjendjes Së Emergjencës Civile
7. V E N D I M Nr.531, Datë 1.8.2003 Për Organizimin, Funksionimin, Detyrat Dhe Përgjegjësitë E Shërbimit Të Emergjencave Civile
8. Vendim Nr. 965, Datë 2.12.2015 Për Bashkëpunimin Ndërinstitucional Të Strukturave Të Drejtimit, Në Rastet E Emergjencave Civile Dhe Krizave

1.5 . MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar. Kandidatët do të vlerësohen për pervojen, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “ëëë.dap.gov.al”

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerëimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Belsh dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerezore (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

2. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Këtë informacion do ta merrni në faqen e Bashkisë Belsh, duke filluar nga data **04.08.2020**.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a- Të jetë shtetas shqiptar;
- b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.
Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:
- g- Të zotërojnë diplomën Bachelor dhe Master Profesional në Shkencat Juridike.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhen pranë njësisë së Burimeve Njerëzore, Bashkia Belsh ose nëpërmjet shërbimit postar, Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës **04.08.2020**.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **14.08.2020.**, Bashkia Belsh do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Bashkia Belsh, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

1. Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
2. Ligjin nr. Nr.139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”;
3. Njohuritë mbi Ligjin nr. 93/2015, "Për turizmin", i ndryshuar;
Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
Njohuritë mbi VKM nr. 298, datë 20.4.2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit”;
4. Njohuritë mbi "Strategjinë Kombëtare për zhvillimin e qendrueshëm të turizmit 2019-2023", (<http://ëëë.mjedisi.gov.al/ëp-content/uploads/2019/06/Strategjia-Kombëtare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>).
5. Ligj Nr. 45/2019 Për Mbrojtjen Civile
6. Nr. 664, Datë 18.12.2002 Për Kriteret Dhe Procedurat E Shpalljes Së Gjendjes Së Emergjencës Civile
7. V E N D I M Nr.531, Datë 1.8.2003 Për Organizimin, Funksionimin, Detyrat Dhe Përgjegjësitë E Shërbimit Të Emergjencave Civile
8. Vendim Nr. 965, Datë 2.12.2015 Për Bashkëpunimin Ndërinstitucional Të Strukturave Të Drejtimit, Në Rastet E Emergjencave Civile Dhe Krizave

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme; c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “ëëë .dap.gov.al” <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015> .

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Belsh do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Belsh dhe në “Portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit” për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive: për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak, datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi; Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkisë Belsh duke filluar nga data **14.08.2020**.

**KRYETAR
ARIF TAFANI**

**Në mungesë dhe me porosi
Sekretar i Përgjithshëm
Mustafa ÇARÇIU**